



CSX.0345

CONSILEX IDROPLUS

Hidroizolues me bazë uji për materiale të buta, me qëndrueshmëri alkalike

Amballazhimi

- Bidon 5 l
- Bidon 10 l
- Bidon 25 l

Aplikimi

- Spërkatje pa ajrim me presion të ulët.
- Brushë

Familja
Consilex

Tipologjia
Tretësira ujore silani ose siloksani

Linjat e produkteve
• Aqua
• Building

Kategoritë e përdorimit
• Trajtime kundër ujit për suvara dhe muratura
• Trajtimi antikripë i muraturave
• Perforcim dyshemeje për sipërfaqe në gur natyral dhe veshje guri

Përbërësit
Monokomponent

Paraqitja
I lëngshëm

Përshkrimi i produktit

CONSILEX IDROPLUS është një përshpejtues silikoni i përqendruar, i formuluar për hidrofobim, trajtim kundër kripave dhe konsolidim të materialeve minerale për ndërtim, që kanë aftësinë e absorbimit të alkaleve. VOC (Komponimet organike të paqëndrueshme) = 0

Të dhëna shtesë

CONSILEX IDROPLUS është veçanërisht i përshtatshëm për:

- Artifakte në argjil të pjekur
- Tjegulla
- Tulla
- Llaç, suva dhe konglomerate të çimentos
- Suva
- Gurë natyralë
- Materiale minerale për izolim termik


Konsumi


CONSILEX IDROPLUS përdoret sipas porozitetit të sipërfaqes. Kryeni teste paraprake.


Fushat e përdorimit

Trajtimi i ngopjes, hidroizolimi, mbrojtja, konsolidimi dhe trajtimi alkalizues i materialeve absorbuese.


Vetitë kryesore

 Jetëgjatësia:
12 muaj

 Pa tretës

 Të përdoret me doreza mbrojtëse

 Të përdoret me syze mbrojtëse

 Ngjyrat në dispozicion
E tejdrukshme

Veçoritë teknike

pH: > 13 _

Substancë aktive: ± 50 %

Mjetet e pastrimit

- Ujë

Shtresat e lejuara

- Suva
- Beton
- Llaçe çimentoje, gëlqereje e të përziera
- Gipse
- Shtuf
- Muratura të përziera
- Muratura me gurë
- Gurë natyrorë dhe porfiret

IF YOU WANT TO SOLVE IT
 **azichem**

www.azichem.com

Përditësimi më: 25/08/2020
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer

Përgatitja e shtresave (mbështetëse)

Substratet duhet të jenë të pastra dhe pa pluhur. Në veçanti, kushtojini vëmendje masave të kripave të përqëndruara, papastërtive, yndyrnave, vajrave, bojrave, myshkut dhe barërave të këqija, të cilët mund të pengojnë depërtimin e produktit në thellësi dhe që duhet të hiqen paraprakisht.

Mënyra e përdorimit

CONSILEX IDROPLUS mund të aplikohet, pas hollimit, për të pastruar sipërfaqet minerale absorbuese, nëpërmjet përdorimit të një spërkatësi me presion të ulët, rulit, furçës ose me zhytje totale. Aplikoni produktin në mënyrë homogjene dhe uniforme, duke spërkatur me presion të ulët ose me një furçë disa herë, mundësisht pa ndërprerje ose në intervale kohore midis herëve, duke treguar veçanërisht kujdes që të arrihet ngopja më e mirë e sipërfaqes së murit.

Për trajtimin e materieleve qeramike gres, si tjegullat, tullat, rekomandohet hollimi i materialit në raportin nga 1:10 në 1:100 pjesë, në varësi të peshës. Hollimi i saktë duhet të përcaktohet me teste eksperimentale. Për llaçin e papërshkueshëm nga uji me çimento ose gips, gurët natyralë, hollimet e rekomanduara janë në raportin nga 1:10 në 1:30 pjesë, në varësi të peshës.

Aplikoni CONSILEX IDROPLUS vetëm në sipërfaqe të pastra nga mineralet, të thata dhe absorbuese që nuk preken nga fenomenet e rritjes së kapilarëve. Këshillohet mbrojtja e artifaktëve të trajtuar nga shiu deri në zhvillimin e plotë të repelencës së ujit. Sidoqoftë është e këshillueshme që të kryhen teste paraprake mbi materialin që do të trajtohet, për të verifikuar kushtet optimale të funksionimit dhe hollimet e sakta të përdorimit.

Për shkak të tipareve alkalike të larta të CONSILEX IDROPLUS, është thelbësore që të gjatë punës me produktin të tregohet kujdes, dke përdorur syze, maskë, doreza mbrojtëse dhe uniformë/përparëse të papërshkueshme nga substancat e lëngshme.

Magazinishimi e Ruajtja

Ruhet nga ngrica. Ruajeni produktin në ambalazhimin origjinal, në një mjedis të freskët dhe të thatë, duke shmangur acarin dhe rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Produkti duhet të ruhet në një temperaturë nga +5°C në +35°C.



www.azichem.com

Përditësimi më: **25/08/2020**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer

Paralajmërimi, Masa paraprake, Ekologji

Të dhënat e përgjithshme, ashtu si dhe indikacionet dhe sugjerimet për përdorimin e këtij produkti, të paraqitura në këtë fletë teknike të të dhënave dhe mundësisht të shpjeguara dhe me gojë ose me shkrim, përputhen me gjendjen aktuale të njohurive tona shkencore dhe praktike.

Të dhënat teknike dhe të performancës të paraqitura janë rezultat i provave laboratorike të kryera në një mjedis të kontrolluar dhe si të tilla mund të ndryshojnë në lidhje me kushtet e vënies në funksionim.

Azichem Srl nuk merr asnjë përgjegjësi që rrjedhin nga performanca jo e duhur që ka lidhje me përdorimin jashtë rregullave të produktit, ose që ka lidhje me defektet që rrjedhin nga faktorë ose elementë që nuk kanë lidhje me cilësinë e produktit, duke përfshirë këtu dhe konservimin e pasaktë.

Kushdo që synon të përdorë produktin duhet të vendosë, para përdorimit, nëse është i përshtatshëm për përdorimin e synuar, duke marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë e tij.

Karakteristikat teknike dhe të performancës të përfshira në këtë fletë të dhënash teknike përditësohen në mënyrë periodike. Për një konsultë në kohë reale lidhuni me sitin: www.azichem.com. Data e rishikimit paraqitet në cep të produktit. Ky njoftim anulon dhe zëvendëson çdo njoftim tjetër të mëparshëm.

Mos harroni se përdoruesi është i detyruar të lexojë Fletën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së këtij produkti, që përmban të dhëna kimike-fizike dhe toksikologjike, parashikimet e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim që të transportojë, përdorë dhe asgjësojë produktin dhe paketimin e tij me siguri të plotë. Për konsultim lidhuni me sitin: www.azichem.com.

Ndalohet hedhja e produktit dhe / ose amballazhit të tij në mjedis.

CONSILEX IDROPLUS prodhohet/shpërndahet nga



Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Itali
info@azichem.com Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398



www.azichem.com

Përditësimi më: **25/08/2020**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer